



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:149572

Datë: 05.04.2024

Numri i dokumentit: 05549575

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.S., nga fshati ... Komuna Gjakovë, për shkak të veprës penale Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore- Departamenti Përgjithshëm në Gjakovë, PP/II nr.854/21 të datës 01.06.2023, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **04.04.2024**, në prani të Prokurorit të shtetit Qazim Xharra, mbrojtësit të akuzuarit av. Shaqir Vula sipas autorizimit si dhe të akuzuarit E.S., me datën 05.04.2024, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **E.S.**, i lindur me dt...., në ..., tani me banim në fshatin ... Komuna Gjakovë, nga i ati ... dhe e ëma . e gjinisë .. ka të kryer IV klasë të shkollës fillore, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, atë i 4 fëmijëve, me nr.personal..., egjiptian, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

- Gjatë muajit Gusht të vitit 2020, në Gjakovë, i pandehuri përpilon dokument publik të falsifikuar dhe atë Lejë qëndrimin Gjerman me nr.YOLFEL1PG7, në emër të V.B., me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal, në atë mënyrë që me qëllim të sigurimit të Leje qëndrimit gjerman, V..B. ia ka paguar të pandehurit E. S.. si paradhënie shumë prej 2500 euro, ashtu që i pandehuri E. pasi e pajisë atë me leje qëndrim, Vl.tenton të udhëtojë për në Dyseldorf të Gjermanisë, ku gjatë një kontrole nga ana e zyrtareve policor ndalohet në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" dhe i sekuestrohet leja e qëndrimit, e që pas ekzaminimit të dokumentit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë në Prishtinë me nr. AKF/2020-1871/2020-1621, dt.05.10.2020 është konstatuar se dokumenti është e falsifikuar.

-me çka ka kryer veprën penale Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së .

Gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17, 38, 39,43, 46, 47, 48, 49,69, 70, 71 par. 1 nën paragraf 1.1 dhe 1.3 dhe nenit 390 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) viteve**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, e në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet, si dhe

DËNIM ME GJOBË në shumë prej **500.-€ (pesëqind) euro**, të cilin shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 60 ditësh , pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 44 të KPPK-së, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **25 (njëzet e pesë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.00.-€ (njëzet) euro të gjobës**.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej **30.00.-€**, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej **20.00.-€**, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

1.Ecurija e procedurës penale

Prokuroria Themelore-Departamenti Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngritë aktakuzën me numër PP/II nr.854/2021 të datës 01.06.2023, kundër të akuzuarit E.S., nga fshati... Komuna Gjakovë ,për shkak të veprës penale Falsikim i dokumenteve nga neni 390 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Qazim Xharra gjatë shqyrtimit fillestar të datës 04.04.2024 , e lexon aktakuzën PP/II nr.854/2021 të datës 01.06.202 dhe deklaron se mbetet në tërësi pranë aktakuzës .

I akuzuari E.S., në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 04.04.2024 , duke u deklaruar lidhur me fajësinë deklaroi se pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e ti av. Shaqir Vula thekson se e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet sipas aktakuzës dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtoj se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer , premtojë se në të ardhmen një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe do të jem me i kujdesshëm, andaj edhe i propozoi gjykatës të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë, premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet ,kërkim falje publike ne gjykatë, gjendjen e dobët ekonomike , punëtor , të më shqiptoi një dënim më të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Shaqir Vula deklaroi se me qe i mbrojturi im pas konsultimit të mjaftueshëm me mua si mbrojtës , ka pranuar fajësinë e qe ky pranim i fajësisë është bere ne mënyrë vullnetare dhe pa presion , duke i kuptuar edhe pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë , po ashtu pranimi i fajësisë gjenë mbështetje edhe ne shkresa të lëndes qe i bashkëngjiten aktakuzës, i propozoi gjykatës qe të pranohet pranimi i fajësisë nga i mbrojturi im . Lidhur me vendimin mbi dënimin i propozoi gjykatës që si rrethanë lehtësueses të merret pranimi fajësisë ne shqyrtimin fillestare, premtim i se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, kërkim falje publike nga i akuzuari ,gjendjen e tij të dobët ekonomike , ti shqiptojë një dënim me të butë me të cilën do të arrihet qëllimi i dënimit .

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari Prokurori i shtetit Qazim Xharra , deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi qe ky pranim i fajësisë është bere në mënyrë vullnetare dhe pa presion ,duke i ditur pasojat dhe benefitet e një pranimi të tillë si dhe është bere pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij , po ashtu faktin se pranim i fajësisë mbështet në faktet e çështjes ,respektivisht provave materiale dhe personale qe përmban aktakuza në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike si ne dispozitiv të aktakuzës , ku edhe janë përmbushur elementet qenësorë të veprës penale me të cilën ngarkohet . Lidhur me vendimin për dënim i propozon gjykatës që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh edhe përgjegjësinë dhe rrezikshmërinë e veprës penale , e po ashtu qëllimi e dënimit duke vlerësuar të gjitha rrethanat si ato lehtësuese si pranim i fajësisë

,ndërsa si rrethanë renduese të ketë parasysh dashjen e lartë në kryerjen e veprës penale si dhe lartasin e demit të shkaktuar .

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari E.S., , ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari , pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Shaqir Vula , pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendjet faktike të vërtetuara

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :-

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari G.B., :- Gjatë muajit Gusht të vitit 2020, në Gjakovë, i pandehuri përpilon dokument publik të falsifikuar dhe atë Lejë qëndrimin Gjerman me nr.YOLFEL1PG7, në emër të V.b., me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal, në atë mënyrë që me qëllim të sigurimit të Leje qëndrimin gjerman ,V.B., ia ka paguar të pandehurit E.S., si paradhënie shumë prej 2500 euro, ashtu që i pandehuri E. pasi e pajisë atë me leje qëndrim, V.. tenton të udhëtojë për në Dyseldorf të Gjermanisë, ku gjatë një kontrole nga ana e zyrtareve policor ndalohet në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” dhe i sekuestrohet leja e qëndrimin, e që pas ekzaminimit të dokumentit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë në Prishtinë me nr. AKF/2020-1871/2020-1621, dt.05.10.2020, është konstatuar se dokumenti është e falsifikuar.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 390 paragrafi .1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale, Falsifikim i dokumenteve e kryen: “*. Kushdo që përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër (4) vjet.*

Ndërsa në par.2, të po këtij neni parashihet se :*nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në lidhje me dokumentin publik, testamentin, kambialin, regjistrin publik apo zyrtar ose ndonjë regjistër tjetër që ruhet në bazë të ligjit, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.*

5. Vendimet e gjyqtarës së vetme gjykuese

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, Gjatë pranimi të fajësisë gjykata konstatoi se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimit të mjaftueshëm edhe me mbrojtësin e tij av. Shaqir Vula, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjykata të akuzuarin E.S., , e ka shpallur fajtorë për veprën penale për të cilën ngarkohet ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitivin

e aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, bazuar në këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tije.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të parapara nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikonin në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethana rënduese gjykata konsideron faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dashjen e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale „rrezikshmërinë konkrete të veprës penale si dhe faktin se i akuzuari nga Evidenca penale data baza e kësaj gjykate rezulton se i njëjti evidentohet vetëm me një lëndë sipas aktgjykimit P.nr.266/21-neni 33 –Dënim me gjobë në shumë prej 3000 euro i PF. dt.09.12.2022 .Ndërsa rrethana lehtësuese gjykata i ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se baba i 4 fëmijëve ,moshën e tij , sjelljet tejet korrekte në Gjykim, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar , premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pendimi i shprehur për veprën e kryer ,kërkim falja publike në gjykatë si dhe fakti se pas këtij rasti nuk evidentohet me ndonjë lëndë tjetër penale . Kështu që duke mos gjetur rrethana posaçërisht rënduese për të akuzuarin gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret eksitojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 70 të KPRK-së , kur i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të aktgjykimi, me bindje se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38dhe 47 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen do të bëjë rehabilitimin e tij, dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7.Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marrë konform nenit 449 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 39 paragrafi 3, nën.par. 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.2021:149572 me datën 05.04.2024

Sekretarja juridike
Flutur Nagavci

Gjyqtarja
Ilirjana Hoti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.